

VENDIM
Nr. 94, datë 30.4.2007

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE ORGANIKËS SË ENTIT RREGULLATOR
TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË
UJËRAVE TË NDOTURA (ERRU)**

(Ndryshuar me vendimin nr. 162, datë 28.2.2008)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 10 pika 1 të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, me propozimin e Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU),

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË


VENDOSI:

- I. Struktura e ERRU-së është sipas lidhjes nr.1 bashkëlidhur.
- II. Organika e ERRU-së është sipas lidhjes nr.2 bashkëlidhur.
- III. Numri i punonjësve të ERRU-së është 21.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

STRUKTURA
E ENTIT RREGULLATOR TË
SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË
DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË
UJËRAVE
TË NDOTURA (ERRU)

Lidhja nr. 1



**ORGANIKA E DETAJUAR E ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
(ERRU)**

(Ndryshuar me vendimin nr. 162, datë 28.2.2008)

KOMISIONI I ERRU-SË	Kategoria e pagës	Numri i punonjësve
KRYETARI		1
ANËTARË KOMISIONI		4
Sekretarja e Komisionit dhe Kryetarit		
1		
DREJTORIA TEKNIKO-EKONOMIKE		8
Drejtor drejtorie		1
Sektor Teknik dhe IT		
Përgjegjës sektori	III-a	1
Specialist i rrjeteve inxhinierike të ujësjellësve dhe ITUP	III-b	1
Specialist i rrjeteve inxhinierike të KUZ dhe ITUZ	III-b	1
Specialist i licencave dhe IT	III-b	1
Sektori Ekonomik dhe Monitorues		
Përgjegjës sektori	III-a	1
Specialist i vlerësimit të kostos dhe tarifave	III-b	1
Specialist i monitorimit dhe verifikimit të treguesve të punës	III-b	
1		
Sektori Juridik dhe i Marrëdhënieve me Publikun		
Përgjegjës sektori	III-a/1	1
Specialist	III-b	1
Sektori i Administratës, Financës dhe Burimeve Njerëzore		
Përgjegjës sektori	III-a/1	1
Specialist finance	III-b	1
Punonjës mbështetës		
Arkivist-protokollist		1
Shoferë		
2		
		21